

VENDIM
Nr.359, datë 10.9.1997

PËR MODALITETET E PRANIMIT TË PUNONJËSVE MËSIMORË DHE
SHKENCORË TË JASHTËM NË SHKOLLAT E LARTA

Në zbatim të ligjit nr.7810, datë 6.4.1994 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 27, me propozimin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI :

1. Punonjësit mësimorë dhe shkencorë të jashtëm (të huaj), të cilët thirren për të plotësuar nevojat e procesit mësimor-shkencor në shkollat e larta, duhet:

- Të kenë përvojë akademike.
- Të provojnë pajtueshmërinë e përvojës akademike me fushën në të cilën do të ushtrojnë veprimtarinë akademike ose shkencore.

- Të paraqesin dy rekomandime nga profesorë të institucioneve akademike nga ata vijnë.

Për punonjësit mësimorë dhe shkencorë të jashtëm (vendas) rekomandimet merren nga profesorë që njohin procesin e formimit të tyre.

2. Shkollat e larta i thërrasin punonjësit mësimorë dhe shkencorë të jashtëm (të huaj) në kuadrin e marrëveshjeve shtetërore ose universitare. Me kërkesë të strukturave akademike të shkollës, titullari i saj (rektori), në raste të domosdoshme, mund të thërrasë punonjës mësimorë dhe shkencorë të jashtëm (të huaj) edhe me emër personal dhe në këtë rast pasi të jetë siguruar mbështetja financiare.

Përgjithësisht punonjësit mësimorë dhe shkencorë të jashtëm (të huaj), përveç kushteve të pikës 1, duhet të kenë grada shkencore ose tituj akademikë. Përjashtim mund të bëjnë punonjësit mësimorë dhe shkencorë të jashtëm (të huaj) në fakultet ose departamentet e gjuhëve të huaja, të cilët thirren edhe në rastet kur nuk kanë grada shkencore a tituj akademikë, por kanë një përvojë mësimdhënieje universitare ose jouniversitare.

3. Kur për të njëjtin vend pune me kohët e pjesshme ka më shumë se një kandidat, zgjedhja bëhet me konkurrim.

4. Marrëdhëniet e punonjësve mësimorë dhe shkencorë të jashtëm, të cilët thirren për të plotësuar nevojat e procesit mësimor-shkencor në shkollat e larta, rregullohen me kontratë që hartohet në përputhje me statutin e shkollës së lartë dhe miratohet nga titullari i institucionit.

5. Kontrata siguron plotësimin e kushteve të shprehura në pikat 1, 2 e 3 dhe përcakton afatin, ngarkesën e veprimtarisë mësimore a shkencore dhe kushtet financiare.

- Kontrata lidhet në fillim të çdo viti akademik. Punonjësit mësimorë e shkencorë të jashtëm (të huaj), veprimtaria e të cilëve zgjat nën 15 ditë, nuk lidhin kontratë, por në të gjitha rastet duhet të plotësojnë kushtet e shprehura në pikat 1, 2 e 3 dhe të kenë miratimin e titullarit të institucionit pritës.

- Ngarkesa e veprimtarisë së punonjësit mësimor dhe shkencor të jashtëm duhet të jetë në pajtim me normat mësimore të punës në shkollat e larta.

- Trajtimi ekonomik i punonjësve mësimorë dhe shkencorë të jashtëm (të huaj) që thirren në shkollën e lartë, rregullohet në bazë të kushteve të përcaktuara në marrëveshje ose kontratë.

6. Modalitetet e trajtimit ekonomike në kontratë duhet të jenë të pajtueshme me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.357, datë 8.8.1994 "Për trajtimin e studentëve të huaj universitarë dhe pasuniversitarë, pedagogëve të huaj që studiojnë ose ushtrojnë veprimtari akademike, sipas marrëveshjeve të ndërsjella në Republikën e Shqipërisë", dhe me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.64, datë 2.2.1996.

Efektet financiare të kontratave parashikohen në buxhetin e institucionit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Fatos Nano